

2014/04

Gjendja e mediave në Kosovë 2014



Instituti për Politika Zhvillimore INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Autor: **Shkamb Qavdarbasha**

Redaktor: **Krenar Gashi**



Bashkëpunimi Rajonal
Regional Cooperation



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development



Qeverisja Demokratike
Democratic Governance

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	3
II. Metodologjia	3
III. Analizë e raporteve ndërkombëtare për Kosovën	4
IV. Problemet e Vazhdueshme	7
V. Përfundime	9

I. HYRJE

Kosova ka një treg medial plural, një kornizë ligjore e kushtetuese të kënaqshme dhe kuadro të bollshme për profesionin e gazetarisë. Numri i gazetave, revistave, radiove, televizioneve e portaleve në internet është në dhjetëra, të cilat një tregu prej 1.7 milionë banorësh do të mund t'i shërbenin informatë të lirë, të saktë dhe të paanshme. Garancitë më të larta ligjore, megjithatë, mbesin të pazbatuara në praktikë. Raportet ndërkombëtare na renditin në pjesën e fundme të listës së vendeve me liri të medias ndërsa profesioni i gazetarit mbetet i pasigurt në punë dhënie dhe në terren.

Duke konsideruar lirinë e mediave si një ndër shtyllat e një shoqërie demokratike, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) u ka dhënë studimeve të mediave rëndësi të barabartë karshi zgjedhjeve, llogaridhënies mes institucioneve dhe politikës së tranzicionit, në programin tonë të qeverisjes demokratike.

Qëllimi ynë është që të dokumentojmë sa më shumë fakte empirike në fushën e medias duke nxjerrë analiza e rekomandime të rregullta për ligjvënësit dhe autoritetet tjera. Kësisoj, edhe me këtë raport, të tretin me radhë, mëtojmë që të përcjellim skenën mediale të Kosovës duke u bazuar në dy perspektiva, si e shohim veten dhe si na shohin të tjerët.

Gjendja e Mediave në Kosovë, ani pse raport i thjeshtë në përmbajtje, është shndërruar në të vetmin publikim të rregullt që trajton çështjen e lirisë së medias në Kosovë. Edhe sivjet, raporti është i ndërtuar në mënyrë që të nxjerrë përfundime të sakta dhe segmentore. Mangësi e këtij raporti është lënia anash e studimit të tregut medial, të cilin segment INDEP mëton ta analizojë në hollësi në të ardhmen.

II. METODOLOGJIA

Nëpërmjet këtij raporti, INDEP ka synuar të identifikojë politikat të cilat shkaktojnë problemet që raportet ndërkombëtare dhe vendore i kanë veçuar si të vazhdueshme në sektorin e mediave. Për të arritur këtë qëllim, INDEP ka përdorur metoda të shumëfishta të hulumtimit gjatë fazës së përpilimit të raportit.

INDEP ka përzgjedhur katër botime të ndryshme të detajuara vjetore ndërkombëtare, të cilat e analizojnë gjendjen e mediave në Kosovë. Raportet janë përzgjedhur në bazë të dominimit, metodologjisë së zhvilluar dhe të vërtetuar të vlerësimit, konsistencës, pavarësisë, donatorëve të ndryshëm dhe profesionalizmit të tyre. Më pas, në këto raporte janë analizuar informatat në vijim: ndonjë apo të gjithë faktorët e notës apo pikëve lidhur me fushën e mediave si dhe të gjitha përfundimet, qofshin pozitive apo negative, lidhur me fushën e mediave për të gjitha vitet kur janë botuar raporte për Kosovën.

INDEP ka përdorur të gjitha notat dhe pikët për të përcaktuar trajektoren e përgjithshme të performancës së sektorit të mediave në Kosovë përgjatë viteve. Të gjitha diagramet e paraqitura në këtë punim janë prodhuar nga INDEP, përveç në rastet e specifikuara ndryshe, duke përdorur të dhënat e organizatave Freedom House, Nations in Transit, Reporters Without Borders, Media Freedom Index, European Union Country Progress Reports, IREX Media Sustainability Index.

Çështjet e përbashkëta dhe të vazhdueshme – çdo çështje e cila është identifikuar për tri apo më shumë vite është konsideruar si çështje e vazhdueshme. Çështje të përbashkëta janë konsideruar

ato çështje të cilat janë identifikuar në së paku tri nga raportet ndërkombëtare që janë cekur më lartë për tri apo më shumë vite me radhë. Çështjet negative të cilat hynë në të dy kategoritë, mirëpo të cilat janë identifikuar si çështje të cilat janë zgjidhur dhe që nuk janë përsëritur më nuk janë marrë parasysh në analizën e detajuar. Si rezultat i kësaj, INDEP ka ardhur në përfundim se ekzistojnë katër çështje kryesore të cilat përsëriteshin dhe ishin të katër përbashkëta në raporte dhe ato janë analizuar në mënyrë të detajuar në fund të këtij punimi. Analiza në vazhdim është një hulumtim kualitativ i cili vlerëson kornizën ligjore, politikat dhe praktikat për të gjitha çështjet.

INDEP gjithashtu ka vlerësuar te gjeturat e raportit Gjendja e Mediave në Kosovë 2013, ku është analizuar niveli i implementimit të rekomandimeve. Të gjitha çështjet e përbashkëta dhe të vazhdueshme të vitit të kaluar për të cilat nuk ka pasur përmirësim janë trajtuar në këtë punim.

Analizat që gjenden këtu janë të bazuara në fakte dhe politika të cilat, sipas njohurive më të mira të autorëve gjatë kohës së botimit, ishin korrekte.


III. ANALIZË E RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE PËR KOSOVËN

Kosova mbetet një nga shtetet e cila akoma po kalon në periudhë tranzicioni dhe shtet ndërtimi. Në shtete të tilla, me histori të strukturave autoritare, mediat janë një nga sektorët me të ndikuar. Për këtë arsye, shumë institucione ndërkombëtare që punojnë në fushën e mediave fokusohen në monitorimin e lirisë së medias në vende në tranzicion.

Një nga raportet kryesore të këtilla në Kosovë mbetet Raporti i Progresit të Komisionit Evropian. Ky raport publikohet çdo vit për secilin shtet i cili synon aderimin në Bashkimin Evropian dhe në të cilin shtjellohet përparimi që shteti në fjalë ka bërë rreth harmonizimit të legjislacionit dhe politikave të tij me ato të Bashkimit Evropian. Gjatë 2013, në Raport të Progresit të KE janë shënuar disa probleme me sferën e mediave në Kosovë, shumë nga të cilat përsëriten nga vitet e kaluara. Ndërkohë që në vitet e kaluara mungesa e legjislacionit për sa i përket lirisë së mediave ka qenë problematike, gjatë 2013 prania e fragmentimit të tepërt të ligjeve për media përbën një sfidë të konsiderueshme.

Sipas KE, një fragmentimi i tillë lë hapësira të shumta për sa i përket rregullimit të mediave, hapësira të cilat duhet të mbushen. Në Raportin e Progresit për vitin 2013 thuhet qartë se kërcënimet ndaj gazetarëve dhe redaktorëve si dhe ndërhyrja politike mbetet një problem i vazhdueshëm. Për më shumë, Raporti i Progresit tërheq vëmendjen për sa i përket ndërhyrjes politike në caktimin e anëtarëve të bordeve të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) si dhe Komisionit të Pavarur të Mediave, ky i fundit përgjegjës për licencimin e transmetuesve si dhe mbikëqyrjen profesionale dhe etike të tyre. Këto të gjetura shënojnë një ngecje nga përparimet e vitit paraprak sipas Raportit të Progresit ku është pritur mirë aprovimi i ligjeve të reja për KPM dhe RTK si dhe ku janë shënuar avancime në politikat audio vizuale në Kosovë.


Raportet Nations in Transit dhe Freedom of the Press nga Freedom House për vitin 2012 janë fokusuar tek problemet ligjore, probleme të cilat janë adresuar gjatë vitit 2013. Megjithatë, të gjeturat negative të cilat sipas Freedom of the Press të identifikuar në vitin 2012 vazhdojnë të jenë relevante. Sipas këtyre raporteve, vonesa në funksionalizimin të bordit të KPM-së vazhdon të jetë problematike, sidomos duke pasur parasysh ndërhyrjen politike në këtë proces. Një gjë e tillë vlen edhe për RTK-në, pa marrë parasysh se këto raporte theksojnë si zhvillim pozitiv aprovimin e ligjit të RTK-së gjatë vitit 2012. Nga ana tjetër, presioni tek gazetarët dhe mediat në përgjithësi vazhdon të jetë i pranishëm sipas këtyre raporteve, duke theksuar se një presion i tillë tanimë bëhet nëpërmjet kërcënimeve financiare. Raportet fokusohen tek fakti se këto presione formohen kryesisht nëpërmjet kontrollit të reklamave nga biznese të afërta me pushtetin. Siç mund të shihet në tabelën më poshtë, renditja i Kosovës për sa i përket lirisë së mediave akoma mbetet në një pozitë të pafavorshme, një renditje e cila nuk ka ndryshuar shumë kohëve të fundit.



Reporters Without Borders publikon çdo vit një rendim të vendeve botërore sipas lirisë së shtypit dhe shprehjes në këto vende. Kosovo ka shënuar një ngritje të lehtë nga viti në vit, dhe nga viti 2013 Kosova është përmirësuar në renditje për 5 vende duke ardhur në pozitën 80. Sipas të dhënave të tabelës, vendi për herë të parë është renditur më mirë se mesatarja e të gjithë vendeve të Ballkanit perëndimor, një faktorë inkurajues për Kosovën. Sidoqoftë, duhet theksuar se kjo arsye ka ardhur kryesisht për shkak të përkeqësimit të situatës mediale në vende të tilla si Kroacia dhe Maqedonia.


Reporters Without Borders - Indeksi Botëror i Lirisë së Mediave

Krahasim në mes të Kosovës, BE-së dhe Ballkanit Perëndimor



Media Sustainability Index i publikuar çdo vit nga IREX, duket se ka ndërruar qasje për sa i përket raportimit në Kosovë, duke treguar përmirësim substancial. Siç mund të shihet nga tabela më poshtë, vendi vazhdon duket se ka shënuar përmirësim për sa i përket indikatorëve të matur në këtë raport. Në raportin e 2014 nga ky institucion thuhet se presioni ndaj gazetarëve nuk është po aq problematik sa ka qenë në të kaluarën. Sidoqoftë, raporti streson se vetë censurimi vazhdon të jetë problem serioz, sidomos për sa i përket presionit nga bizneset tek redaksitë e mediave. Raporti gjithashtu thotë se legjislacioni për sa i përket mediave në vend ka përparuar konsiderueshëm, sidomos duke konsideruar adoptimin e ligjit për mbrojtje të burimeve të gazetarëve i cili është adoptuar gjatë vitit 2013. Nga ana tjetër, implementimi i ligjit për Qasje në Dokumente Publike vazhdon të mbetet i mangët, dhe një gjë e tillë i lë gazetarët në një pozitë të pafavorshme.

IREX - Media Sustainability Index - Kosovo



Nga ana tjetër raporti i IREX identifikon problemet të vazhdueshme me KPM-në, duke theksuar probleme në caktimin e anëtarëve të bordit si dhe ndërhyrjen politike në këtë institucion. Panelistët e këtij raporti duket se theksojnë se mungesa e funksionalizimit të këtij institucioni e ngadalëson procesin e dixhitalizimit të transmetimit në Kosovë, një problem i cili ndikon transmetuesit. Nga ana tjetër, raporti gjithashtu thekson se financimi i transmetuesit publik, RTK, nga fonde shtetërore ndikon në politikat redaktoriale dhe pavarësinë e këtij institucioni. Përfundimisht, menaxhimi biznesor i mediave në vend, po sipas këtij raporti, lë shumë për të dëshiruar.

Në përgjithësi, raportet ndërkombëtare që monitorojnë gjendjen e mediave në Kosovë shënojnë një përmirësim të lehtë nga viti 2012 në 2013. Këto përmirësime vihen re kryesisht në fushën e legjislacionit të mediave si dhe uljes së numrit të sulmeve ndaj gazetarëve. Sidoqoftë, kjo e fundit është e vetë raportuar nga disa panele, dhe një gjendje statistike e sulmeve ndaj gazetarëve nuk ekziston për momentin në vend, sidomos duke pasur parasysh ngadalësimin e punës së Asociacionit të Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK). Nga ana tjetër, disa probleme madhore vazhdojnë të përsëriten nga vitet e kaluara. Këto probleme fokusohen kryesisht rreth funksionit të trupave rregullativ dhe vetë rregullative të mediave në vend, ndërhyrjes së politikës dhe biznesit në politikat redaktoriale të mediave, private dhe publike, implementimit të bazës ligjore, etj. Një nga problemet kryesore vazhdon të mbetet pluraliteti i lartë i mediave në Kosovë si dhe një treg i ngushtë i reklamave. Këto probleme janë analizuar më në detaj në seksionin më poshtë.

IV. PROBLEMET E VAZHDUESHME

Kosova përbëhet nga dy trupa rregullativ dhe vetë rregullative të mediave – gjegjësisht KPM dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. Komisioni i Pavarur për Media parashihet tek neni 141 i Kushtetutës së Kosovës dhe ka për detyrë licencimin dhe rregullimin e transmetuesve në Kosovë. Licencimi i transmetuesve parashihet që këto media t'i përmbahen një liste të rregullave profesionale, etike, si dhe teknike të parashtruara nga KPM. Ky institucion, nga ana tjetër, ka për detyrë monitorimin e këtyre mediave në mënyrë që të sigurohet implementimi i rregulloreve të saj. Ndërkohë, KPM gjithashtu është përgjegjëse për avancimin e sistemit të transmetimit audio vizual në Kosovë, qoftë nga ana profesionale edhe nga ajo teknike, siç është dixhitalizimi i sistemit transmetues në vend.

KPM, sidoqoftë, ballafaqohet vazhdimisht me një numër problemesh, një pjesë e mirë e të cilave rezultojnë nga ndërhyrja politike në funksionin e këtij institucioni. Ndërhyrja politike në këtë institucion ndodh nëpërmjet ndikimit të procesit të përzgjedhjes së organit më të lartë vendimmarrës të saj, Këshillit. Këshilli i KPM-së përbëhet nga shtatë anëtarë të përzgjedhur nga Kuvendi i Kosovës pas emërimit publik. Sipas ligjit, KPM përmbledh listën e të emëruarve nga publiku dhe dërgon këtë listë te Kuvendi i Kosovës, i cili përzgjedh kandidatët.¹ Nën këtë ligj, kandidatët e propozuar nga komisioni parlamentar ad-hoc përzgjidhen nga Kuvendi.² Sidoqoftë, ky proces ka shfaqur mjaft probleme, duke pasur parasysh interesin e partive politike për të vendosur të emëruar politik pa eksperiencë në fushën mediale në pozita të këtij Këshilli. Në gusht 2012, asnjë nga të emëruarit e Këshillit të KPM-së nuk ka pasur eksperiencë në gazetari.³ Nga ana tjetër, në dhjetor të vitit 2013 janë shkarkuar dy anëtarëve të KPM-së për shkak se ata kanë mbajtur

¹ Nën ligjin e mëparshëm të KPM-së, dy nga anëtarët janë nominuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara, një nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa katër të tjerë janë nominuar nga shoqëria civile dhe një listë e të përzgjedhurve nga KPM i është dërguar Kuvendit të Kosovës për votim.

² Gazeta Jeta në Kosovë, Asnjë gazetar nuk rekomandohet për KPM, 16 gusht 2012, <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,2913>.

³ Gazeta Jeta në Kosovë, Asnjë gazetar nuk rekomandohet për KPM, 16 gusht 2012, <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,2913>.

poste politike ndërkohë që kanë qenë pjesë e këtij institucioni.⁴ Kuvendi ka vazhduar të mos caktojë anëtarë të ri në KPM, duke e bllokuar kështu punën e institucionit.

Këto vonesa dhe probleme në caktimin e trupit më të lartë të KPM-së ka bllokuar disa procese qenësore për një institucion të tillë. Së pari, dixhitalizimi i rrjetit të transmetimit në Kosovë është zvarritur nga viti 2009. Një gjë e tillë e bën të pamundur që transmetuesit të mund të implementojnë metoda më moderne të matjes dhe analizës së shikueshmërisë, duke i ndikuar këto të fundit financiarisht. Nga ana tjetër, KPM vazhdon të funksionojë me gjysmë kapaciteti, duke mos e përmbushur plotësisht rolin e saj të mbikëqyrjes si dhe të zhvillimit të sektorit të transmetimit në vend. Kjo sidomos vëhet re në numrin e lartë të licencave që jepen për transmetues lokal, kur dihet se tregu lokal nuk është në gjendje të absorbojë financiarisht një numër të lartë të mediave. Kjo më tej lë mbrapa sistemin e transmetimit vendor, duke ndikuar kështu në pavarësinë, kualitetin dhe profesionalizmin e mediave të transmetuara.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) vazhdon të ballafaqohet me probleme serioze për sa i përket implementimit të detyrave të tij. Qëllimi parësor i kësaj organizate jo-qeveritare është vetë-rregullimi i operimit dhe sjelljes së mediave të shkruara. Si rrjedhojë, KMSHK ka publikuar Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, i cili synon të rregullojë çështjet morale, etike dhe profesionale të mediave të shkruara në vend. Detyra parësore e KMSHK është hartimi i kodeve etike dhe profesionale për media të shkruara si dhe monitorimi i këtyre mediave si dhe pranimit të ankesave ndaj mediave të shkruara. KMSHK e plotëson detyrën e tyre të rishikimit nëpërmjet një bordi i cili është i formuar nga përfaqësues të lartë të mediave të shkruara në Kosovë. KMSHK financohet nga pagesa të parapara për këtë këshill nga mediat të cilat janë anëtare dhe nga donatorët e huaj.

KMSHK, sidoqoftë, ballafaqohet me shumë probleme për sa i përket implementimit të detyrave. Së pari, anëtarët e KMSHK nuk i paguajnë kontributet ndaj këshillit me rregull apo far. Kjo e bën të pamundur funksionalizimin e plotë të mekanizmave administrativ të këtij institucioni, duke e lënë institucionin me kapacitete të kufizuara. Nga ana tjetër, KMSHK nuk ka përkrahje legjislative nga institucionet shtetërore të Kosovës për sa i përket vendimeve të saj. Si rezultat, ky institucion shpesh anashkalohet nga ankuesit të cilët zakonisht u drejtohen gjykatave për problemet e tyre me media të shkruara. Si rezultat, KMSHK është mjaft e limituar në implementimin e detyrave të saj statutore dhe për të përmirësuar këtë gjendje duhet siguruar një mekanizëm më afat gjatë.

Kosova gjithashtu ka dy asociacione profesionale të gazetarëve, Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës (AGPK) dhe Unioni i Gazetarëve të Kosovës (UGK), ku i pari gëzon numrin më të madh të anëtarëve. Deri më tani, AGPK gëzon anëtarësinë e 240 gazetarëve, reporterëve dhe profesionistëve të tjerë medial. Organi më i lartë i asociacionit mbetet asambleja e anëtarëve e cila zgjedh bordin e drejtorëve të AGPK-së si dhe kryetarin e organizatës. Organizata ka për qëllim mbrojtjen e interesave të gazetarëve si dhe ofrimin e mundësive për avancim profesional për profesionistët medial. Sidoqoftë, kjo organizatë është ballafaquar me një numër të lartë të problemeve të keq menaxhimit që nga themelimi. Gjatë vitit 2012, organizata kishte filluar të funksionojë në mënyrë efektive, me një bord dhe drejtorë të votuar dhe të pranuar nga asambleja. Zgjedhja e bordit të ri në fillim të vitit 2013 është ndjekur nga akuza të politizimit të personave të zgjedhur. Gjatë vitit 2013 dhe fillimit të vitit 2014, AGPK nuk ka publikuar statistikat vjetore të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe nuk ka qenë aktive në mbrojtjen e interesave të tyre.

⁴ Shkarkohen dy anëtarët e KPM-se, Telegrafi, 26 dhjetor 2013, <http://www.telegrafi.com/lajme/shkarkohen-dy-anetar-et-e-kpm-se-2-39504.html>

Ndërkohë që vendi ka aprovuar një numër ligjesh për të rregulluar sektorin e mediave dhe lirisë së shtypit në vend, këto ligje janë të fragmentuara. Nuk ekziston një kornizë e unifikuar ligjore e cila synon që të rregullojë sektorin e mediave, nga të drejtat e gazetarëve deri te rregullatorët, në mënyrë të harmonizuar. Ky fragmentim gjithashtu rezulton në ligje të cilat në raste mbulojnë sektorë të njëra tjetrës. Një gjë e tillë e bën më të vështirë implementimin e tyre nga autoritetet e ndryshme shtetërore, ndjekjen e tyre nga sektori i mediave si dhe gjykimin në rast të kontesteve. Si rezultat është tejet e rëndësishme që një kornizë e harmonizuar ligjore për sa i përket mediave të implementohet në mënyrë që të sigurohet efektshmëria e po kësaj kornize ligjore.

Një nga pasojat kryesore të këtij fragmentimi mbeten portalet e internetit. Të parregulluara dhe pa mbikëqyrje, pronësia, bordet redaktoriale dhe niveli profesional dhe etik i këtyre mediave mbete pa mbikëqyrje. Megjithatë, shtrirja e lartë e qasjes në internet në Kosovë ka siguruar që këto portale të lajmeve të gëzojnë lexueshmëri jashtëzakonisht të lartë ndërkohë që standardet e tyre profesionale ëlahojnë. Si rezultat, konkurrenca që këto portale u bëjnë shtëpive mediale të besueshme është e lartë në të njëjtën kohë duke dëmtuar potencialisht kualitetin e informimit të publikut si dhe duke thyer ligjin mbi pronësinë intelektuale. Prandaj, një zgjidhje e shpejtë ndaj këtij problemi është e nevojshme.

V. PËRFUNDIME

Sektori i mediave në Kosovë është ndikuar nga sfida të shumta gjatë viteve pas përfundimit të luftës. Nga një sferë me publikime dhe transmetues të limituar, numri total i të gjithë mediave në vend është rritur në mënyrë drastike në dhjetëvjeçarin e fundit. Me një shumicë të tillë të mediave, zgjerimin e internetit si teknologji informative dhe një kornizë ligjore të mangët dhe struktura shtetërore jo efektive, problemet të cilat vazhdojnë të ndikojnë mediat janë të shumta.

Kryesisht, raportet ndërkombëtare ndaj mediave në Kosovë tërheqin vëmendjen tek presionet ndaj të cilave vendosen gazetarët. Së pari, kërcënimet dhe sulmet direkte ndaj gazetarëve në Kosovë vazhdojnë të jenë aktive në shifra të cilat janë shqetësuese për një vend si Kosova. Nga ana tjetër, kompensimi monetar i gazetarëve është i vogël ndërkohë që nuk ka siguri në punë si pasojë e mungesës së marrëdhënieve kontraktuale me punëdhënësit. Për më shumë, presione të jashtme nga politika dhe biznese të afërta me politikën bëjnë që bordet redaktoriale dhe gazetarët të ndiejnë nevojën për vetë-censurë. Megjithatë, gjatë viteve shihet një trend i zvogëlimit të kërcënimeve ndaj gazetarëve, një fakt inkurajues. Megjithatë, duhet bërë më shumë punë për të siguruar sigurinë minimale financiare dhe personale të profesionistëve në fushën e mediave.

Nga ana tjetër, institucionet rregullative dhe mbështetëse të mediave dhe gazetarëve vazhdojnë të mos i plotësojnë në mënyrë të kënaqshme detyrat e tyre. Komisioni i Pavarur i Mediave ndikohet politikisht, dhe si pasojë e ndërhyrjeve tek udhëheqësia e tij nuk është në gjendje të përmbushë rrolin e rëndësishëm që luan në mbikëqyrjen, licencimin dhe avancimin e transmetuesve. Komisioni i Mediave të Shkruara të Kosovës, i përbërë nga vetë mediat e shkruara, mbahet peng e mos pagesave dhe mos investimit duke e kufizuar dukshëm aftësinë e këtij organi për të monitoruar mediat e shkruara. Shoqatat e pavarura të gazetarëve në vend janë jo efektive dhe shpesh bien pre e interesave të grupeve të caktuara të interesit. Si rezultat, gazetarët nuk përfaqësohen në mënyrë adekuate tek organet ligjvënëse, u mungojnë mekanizma të pavarura të trajnimit dhe nuk kanë një organizatë ombrellë që të mbrojtë interesat e tyre profesionale. Prandaj, zgjidhja e problemeve të tërë këtyre trupave është një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm në mënyrë që të sigurohet një qëndrueshmëri e orvatjeve për përmirësimin e gjendjes së gazetarëve dhe mediave në vend. Kjo gjë vlen sidomos për sa i përket shumimit të hovshëm të mediave në

internet, pronësia e të cilave është kryesisht jo transparente dhe shumica prej të cilave nuk ndjekin kode profesionale apo ligjin për pronësi intelektuale.

Pa marrë parasysh çfarë është thënë më lartë, korniza ligjore për sa i përket mediave dhe punës së gazetarëve ka shënuar përparime të konsiderueshme në vitet e fundit, lënë anash këtu varfërinë e akteve nënligjore të KPM-së të cilat mbeten improvizime të skajshme. Fyerja dhe shpifja nuk janë më shkelje penale, burimet e gazetarëve mbrohen me ligj si dhe nene të cilat mund të kishin cenuar lirinë e këtyre të fundit janë larguar nga korniza ligjore. Megjithatë, provizionet e shumta për media në Kosovë duhet të harmonizohen në mes vete në mënyrë që të sigurohet që të mos ketë dykuptimësi në mes të provizioneve të ndryshme ligjore dhe që të bëhet interpretimi më i lehtë i tyre.

Mediat në Kosovë kanë shënuar shumë përparime të nevojshme për një sektor të tillë në një demokraci të zhvilluar. Sidoqoftë, gazetarët dhe shtëpitë mediale vazhdojnë të përballohen me sfida nga ato direkte si kërcënime, te ato më të tërthorta si probleme financiare dhe mungesë të kapaciteteve. Megjithatë, çështje parësore vazhdojnë të mbeten mekanizmat e rregullimit të sektorëve të ndryshme mediale si dhe mbrojtja dhe përfaqësimi adekuat i gazetarëve.

